

STATUTI

i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“FitnessAcademy–Albania” sh.p.k

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, - i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”-i ndryshuar, si dhe të Aktit të themelimit të shoqërisë “Fitness Academy–Albania” Sh.p.k, veprimtaria e shoqërisë do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

Neni 1 – Menaxhimi dhe administrimi

1. Ortaku i vetëm, njëherazi edhe Administratori i shoqërisë është Marin Camaj, shtetas shqiptar, lindur më 10/10/1992 me nr. personal J21010080E, banues në Tiranë me adresë të përhershme në Rr. Idriz Dollaku, Pallat i Firmës Domus Sh.p.k, Apartamenti 19, Tiranë- Shqipëri, i cili ka të gjitha kompetencat ekzekutive.

2. Administratori Marin Camaj, emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë rinovim mandati. Ai ushtron detyrën deri në dorëheqje ose shkarkim nga ortaku i vetëm.

3. Administratori ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t’i njihen nga ligji dhe vetë Ai si Ortak i Vetëm.

Neni 2 – Emërtimi, Forma juridike

Emërtimi i Shoqërisë është **“FitnessAcademy–Albania”** Forma Juridike e saj është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.) me Ortak të Vetëm Marin Camaj.



Neni 3 – Emri, Selia dhe kohëzgjatja

1. Emri tregtar i shoqërisë është **“FitnessAcademy–Albania” sh.p.k.**
2. Selia e shoqërisë është: Rr. Idriz Dollaku, Pallat i Firmës Domus Sh.p.k, Apartamenti 19 Tiranë- Shqipëri. Adresa mund të ndryshohet me vendim të Administratorit dhe regjistrohet në QKB.
3. Shoqëria themelohet për një kohëzgjatje të pacaktuar. Si datë e fillimit të aktivitetit do të jetë data e regjistrimit në QKB

Neni 4 – Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Ofrimi i shërbimeve të fitness-it online dhe në palestër;

Shërbime dhe këshillime për mirëmbajtjen fizike dhe shëndetësore trupore;

Organizimi i programeve stërvitore, trajnimeve dhe eventeve sportive;

Importi, eksporti dhe tregtimi i pajisjeve të fitnesit, artikujve sportivë dhe produkteve ndihmëse;

Çdo aktivitet tjetër tregtar i lejuar me ligj dhe që lidhet me objektin e mësipërm.

Neni 5 – Kapitali fillestar dhe kuotat

1. Kapitali fillestar i shoqërisë është **100,000 (njëqind mijë) lekë**, i tëri i paguar nga ortaku i vetëm.
2. Kapitali përbëhet nga 1 kuotë e vetme me vlerë **100,000 lekë**.
3. Kuota e Kapitalit zotërohet nga ortaku i vetëm, Marin Camaj.



Neni 6 – Transferimi i pjesëve të kapitalit

Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.

Pjesa e kapitalit themeltar është lirisht e transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

Neni 7 – Ndryshimi i kapitalit

1. Kapitali fillestar mund të rritet ose ulet me vendim të ortakut të vetëm dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.
2. Çdo ndryshim i kapitalit regjistrohet në QKB.

Neni 8 – Përgjegjësia e ortakut

Kompetencat kryesore

- ☐ - ndryshimi i dispozitave të statutit,
- ☐ - zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit,
- ☐ - emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,
- ☐ - miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,
- ☐ - miratimi i llogarive vjetore(bilancit),
- ☐ - ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë,
- ☐ - mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme shoqërisë si dhe të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi.Ortaku i vetëm nuk mban përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë përtej kapitalit të deklaruar.

Ortaku i vetëm nuk mban përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë përtej kapitalit të deklaruar



Neni 9 – Vendimarrja

- 1.** Vendimet e rëndësishme merren nga ortaku i vetëm dhe regjistrohen në librin e vendimeve.
- 2.** Vendime të tilla përfshijnë: ndryshimin e statutit, ndryshimin e kapitalit, hapjen e degëve, shpërndarjen e fitimit, shpërbërjen e shoqërisë etj.

Neni 10 – Fitimi dhe humbjet

- 1.** Fitimi neto, pas mbulimit të shpenzimeve dhe detyrimeve tatimore, i takon në tërësi ortakut të vetëm.
- 2.** Humbjet mbulohen nga kapitali i shoqërisë.

Neni 11 – Dokumentacioni

Shoqëria është e detyruar të mbajë librat e llogarive dhe dokumentacionin kontabël sipas standardeve dhe ligjit në fuqi.

Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin unik të identifikimit;
- b) formën ligjore të shoqërisë;
- c) vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
- d) të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
- e) vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;

Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

Neni 12 – Degë dhe përfaqësi



Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo përfaqësi brenda dhe jashtë Shqipërisë me vendim të Administratorit.

Neni 13 – Regjimi tatimor

Shoqëria i nënshtrohet detyrimeve tatimore sipas ligjeve në fuqi.

Neni 14 - Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 15 - Bilanci dhe Shpërndarja e Fitimit

Në fund të vitit ushtrimor, administratori, merr masa për përgatitjen e bilancit. Bilanci Shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe miratohet brenda afateve ligjore. Asambleja e ortakëve (Ortaku i Vetëm) që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ose krijimin e rezervave ligjore dhe pagesën e Tatimit mbi Fitimin e shpërndarë, sipas legjislacionit perkatës tatimor.

Neni 16 – Shpërbërja dhe likuidimi

1. Shoqëria shpërbëhet me vendim të ortakut të vetëm ose në rastet e parashikuara nga ligji.
2. Pas likuidimit, ortaku i vetëm merr pasuritë e mbetura pas shlyerjes së detyrimeve.



Neni 17 – Dispozita përfundimtare

Çdo çështje që nuk parashikohet në këtë statut rregullohet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

Data: 09/09//2025

Vendi: Tiranë

ORTAKU I VETËM

Merin Camaj

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Merin Camaj', with a long horizontal stroke extending to the right.